



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

08.02.2016

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

shpall

NJOFTIM PUBLIK

Për angazhimin e eksperteve të fushave funksionale në programet trajnuese

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ka filluar procesin e hartimit të listës zyrtare (bazës së të dhënave) të eksperteve të jashtëm që do të angazhohen në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2016 në AKSP.

Lista zyrtare (baza e të dhënave), do të përbehet nga ekspert të fushave funksionale, si në vijim:

1. Gjyqtar i Gjykatës Themelore/Apelit (departamenti i përgjithshëm).
2. Gjyqtar i Gjykatës Themelore/Apelit (departamentit për krime të rënda) apo Gjykatës Supreme.
3. Gjyqtar i Gjykatës Themelore/Apelit (departamentit për të mitur).
4. Prokuror i Prokurorisë Themelore/Apelit (departamenti i përgjithshëm).
5. Prokuror i Prokurorisë Themelore/Apelit (departamenti i krimeve të rënda), apo Prokurorisë Speciale.
6. Avokat nga Oda e Avokateve të Kosovës.
7. Ekspert nga fusha e Shërbimit Sprovues;
8. Ekspert nga fusha e Qendrës për pune sociale;
9. Ekspert nga fusha e taktikave mbrojtëse;
10. Ekspert nga fusha e mbrojtjes së viktimave;

Kandidatet që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të përfunduar studimet universitare;

2. Të kenë përvojë pune dhe të jenë të punësuar si gjyqtar, prokuror apo avokat, ndërsa për piken 7, 8, 9 dhe 10 të këtij konkursi, eksperti duhet të jetë profesionist i fushës përkatëse;
3. Aftësi profesionale që rrjedhin nga njohuria e lëndës;
4. Të ketë shkathtësi të larta komunikuese dhe organizative;
5. Aftësi për të përdorur kompjuterin.

Përjashtimisht, kandidatet që aplikojnë në fushën e taktikave mbrojtëse, në mungesë të diplomës universitare duhet të dëshmojnë ekspertizën në fushën përkatëse.

Kandidatet e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet si në vijim: Kërkesën me biografi (cv), certifikatën e lindjes apo kopjen e letërnjoftimit, kopjen e diplomës universitare, kopjet e trajnimeve të kryera, dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse, si dhe informata tjera specifike shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike -Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, zyra nr. 01. Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur 8 (tetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së njoftimit publik, respektivisht deri me datën 15.02.2016, në ora 16:00.

Brenda 7 (shtatë) dite nga data e mbylljes së njoftimit publik, Komisioni i emëruar nga Akademia, do të për zgjedh me se shumti nga 3 (tre) ekspert që i plotësojnë më së miri kushtet nga secila fushe e kërkuar. Të njëjtit bëhen pjesë e listës zyrtare (bazës së të dhënave) dhe ftohen për angazhim në programe trajnuese sipas radhës të renditur në listë dhe varësisht nga nevojat e Akademisë.

Angazhimi nuk nënkupton themelimi i marrëdhënies së punës. Kontrata lidhet sipas dispozitave të aplikueshëm që rregullon ofrimin e shërbimeve të veçanta apo punën me honorar me ç' rast kompensohet vetëm dita që angazhohet eksperti.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ofron mundësi të barabartë për gjithë kandidatet e interesuar, andaj inkurajohen të aplikojnë kandidatet me ekspertizë në fushat e kërkuara.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 lok.210 apo 211, ç' do ditë pune prej orës 08:00-16:00.